



Letër Menaxhmenti  
për vitin 2024

## 7 Arte

### Letër Menaxhmenti

---

Për Menaxhmentin e 7 Arte  
Prishtinë, Kosovë

Mars 2025

Të nderuar,

#### **Letër Menaxhmenti për vitin e mbaruar Dhjetor 31, 2024**

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të 7 Arte për vitin e mbaruar Dhjetor 31, 2024, kemi konsideruar strukturën e brendshme në mënyrë që të vendosim për procedurën e auditimit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të audituara, por jo për të ofruar siguri në kontrollin e brendshëm.

Ne kemi kontrolluar në bazë të mostrimit, prova që mbështesin shumat dhe pohimet në pasqyrat financiare. Për më tepër, kemi vlerësuar parimet e kontabilitetit të përdorura nga menaxhmenti.

Qëllimi i kësaj letre të menaxhmentit është që ti prezentoj një sërë rekomandimesh menaxhmentit të 7 Arte duke u bazuar në gjetjet e auditorit përgjatë rrjedhës së auditimit. Synimi i letrës së menaxhmentit nuk është të kritikojë ose dënojë aktivitetet të cilat janë vërejtur. Mirëpo, synimi është që të propozojë përmirësime në fushatë ku auditori mendon se duhet të ketë ndonjë të tillë.

Çështjet e ngritura në këtë letër janë vetëm ato që kanë kapur vëmendjen tonë gjatë rrjedhës së auditimit dhe jo domosdoshmërisht deklarata të plota e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Do të ishte kënaqsi të diskutojmë për çështjet e ngritura gjatë auditimit dhe të asistojmë menaxhmentin për të implementuar ato nëse është e nevojshme.

Poashtu duam që të shprehim falenderimin tonë për bashkëpunimin e menaxhmentit dhe punonjësve të 7 Arte gjatë punës sonë.

Në rast se keni ndonjë pyetje mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

  


ACA – Audit & Consulting Associates  
Prishtina, Kosovë

## **7 Arte**

### **Letër Menaxhmenti**

---

#### **PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT PËR KONTROLL TË BRENDSHËM**

##### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit**

Menaxhmenti është përgjegjës për të themeluar dhe për të mbajtur kontrollin e brendshëm. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, vlerësimet dhe gjykimet e menaxhmentit kërkohen që të vlerësojnë përfitimet e menduara dhe kostot e lidhura të kontrollit.

##### **Objektivat**

Objektivat e kontrollit të brendshëm shërbejnë për t'i dhënë menaxhmentit një siguri të arsyeshme por jo absolute që asetet janë të mbrojtura nga humbja e përdorimit të paautorizuar dhe se transaksionet janë të ekzekutuara në përputhje me autorizimin e menaxhmentit dhe janë të regjistruara në mënyrë të duhur që lejojnë përgaditjen e pasqyrave financiare dhe janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

##### **Kufizimet**

Për shkak të kufizimeve të cilat janë ekzistuese në çdo kontroll të brendshëm, mund të ndodhin deklarata të gabuara të cilat nuk mund të vërehen për shkak të gabimeve ose mashtrimeve. Poashtu, parashikimet e çdo vlerësimi të kontrollit të brendshëm për periudhat e së ardhmes janë të hapura ndaj rreziqeve sepse kontrolli i brendshëm mund të jetë jo-adekuat për shkak të ndryshimeve të kushteve ose rënies së nivelit të pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat.

**7 Arte**  
Letër Menaxhmenti

---

**PËRMBLEDHJE**

1. **GJETJET** .....

**1. GJETJET**

Asnjë çështje nuk është identifikuar.